REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE TRANSPORTIT
MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE I TRANSPORTA
MINISTRY OF INFRASTRUCTURE AND TRANSPORTATION
Njësia org. / Org. Jedinica / Org. Unit: 02
Nr. i Prot. / Broj Prot. / Prot. No.: 6669
Nr. i faqeve / Br. Stranica / No. Pages: 02
Data / Datum / Date: 20.06.19
PRISHTINË/A

21-06-19
REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS
REPUBLIKA KOSOVA - OPŠTINA SUVA REKA
REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA
MARRË NË DORËZIM - PRIMLJENO - RECEIVED

| Njësia org. Org. Jedinica Org. Unit | Numri Broj Number | Shtojca Prilog Appendix | Vlera Vrednost Value |
|---|---|---|---|
| 01 | 016 | 40/03 | 2 |

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
***Qeveria - Vlada - Government***
*Ministria Infrastrukturës dhe Transportit*
*Ministarstvo Infrastrukture i Transporta*
*Ministry of Infrastructure and Transportation*

---

Prishtinë, 21.06.2019

Në bazë të nenit 11 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (GZ nr.07 me dt. 01 mars 2019), si dhe në bazë të nenit 8 paragrafi 1.4 dhe Shtojcës 17 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloret nr.14/2017, Nr.15/2017, Nr.16/2017, Nr.07/2018, Nr. 22/2018, Nr. 26/2018 dhe Nr. 30/2018, nenit 24 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe Ligjit Nr.06/L-133 mbi Ndarjet Buxhetore Për Buxhetin e Republikës së Kosovës Për Vitin 2019, lidhet ky:

## MEMORANDUM MIRËKUPTIMI PËR PËRKRAHJEN E FINANCIMIT TË PROJEKTEVE INFRASTRUKTURORE NË KOMUNËN E SUHAREKËS

### Neni 1
### Palët Nënshkruese

1. **MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE TRANSPORTIT**, e përfaqësuar nga Ministri i MIT-së, (në tekstin e mëtejmë MI),

dhe

2. **KOMUNA E SUHAREKËS**, e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës, (në tekstin e mëtejmë Komuna).

### Neni 2
### Qëllimi

Qëllimi i kësaj letër perkrajeje është zotimi për perkrahje financiare të projektit infrastrukturor të cekur më poshtë si dhe përcaktimi i obligimeve të MIT-së dhe Komunës për financimin e projektit:

1. **Ndërtimi i rrugës "Brigada 123" – Sheshi në Suharekë**, në vlerë prej **1,000,000€;**

**Neni 3**
**Bashkëpunimi**

1.MIT zotohet se do të angazhohet për përkrahjen financiare të projekteve infrastrukturore të cekura në nenin 2.

2. Ky projekt do të jetë pjesë e planifikimit të buxhetit për vitin 2020-2022 të MIT-së;

3. Komuna siguron projektin zbatues dhe një kopje e dërgon në MIT.

4. Komuna obligohet të ndërmarrë dhe kryej çdo lloj shpronësimi të nevojshëm për zbatimin e projektit përfshirë procedurat dhe kompenzimin në bashkëpunim me Ministrinë e Ambientit dhe Planifikimt Hapsinorë dhe Ministrinë e Financave.

**Neni 4**
**Ndryshimet dhe ndërprerja e Memorandumit**

Me pëlqimin paraprak të Ministrit të MI-së dhe Kryetarit të Komunës, ky Memorandum mund të ndryshohet dhe plotësohet.

**Neni 5**
**Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve**

Palët bien dakord reciprokisht për mënyrën e zgjidhjes së të gjitha çështjeve të pazgjidhura në këtë drejtim.

**Neni 6**
**Numri i Kopjeve**

Memorandumi i Mirëkuptimit është nënshkruar në katër (4) kopje, nga dy (2) kopje origjinale për secilën palë nënshkruese.

**Neni 7**
**Hyrja ne fuqi**

Palët nënshkruese janë pajtuar që kjo letërpërkraje të fillon të zbatohet nga dita e nënshkrimit.

| | |
|---|---|
| Ministri i MIT-së | Kryetari Komunës |
| **Pal LEKAJ** | **Bali MUHARREMAJ** |